VENDIM
Nr. 704, datë 30.10.2019

PËR NJË SHTESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2019, MIRATUAR PËR MINISTRINË E MBROJTJES, PËR RIKONSTRUKSIONIN DHE RINDËRTIMIN E BANESAVE TË PREKURA NGA TËRMETI I DATËS 21.9.2019 NË QARQET TIRANË DHE DURRËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, "Për prokurimin publik", të ndryshuar, dhe të nenit 13, të ligjit nr. 99/2018, "Për buxhetin e vitit 2019", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministrisë së Mbrojtjes, në buxhetin e miratuar për vitin 2019, në programin buxhetor "Emergjencat Civile" 10910, i shtohet fondi prej 470 000 000 (katërqind e shtatëdhjetë milionë) lekësh nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit për vitin 2019, për rikonstruksionin dhe rindërtimin e shtëpive të dëmtuara nga tërmeti në qarqet Tiranë dhe Durrës.
2. Ministria e Mbrojtjes caktohet organi përgjegjës për përdorimin e fondeve për rikonstruksionin dhe rindërtimin e shtëpive të dëmtuara nga tërmeti, në qarqet Tiranë dhe Durrës, sipas procedurave të prokurimit publik.
3. Të gjitha fondet në programin buxhetor "Emergjencat Civile" 10910, për vitin 2019, do të përdoren për qëllimin e parashikuar në pikën 1, të këtij vendimi.
4. Ngarkohen Ministria e Mbrojtjes dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama